



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 06.07.2017

Ref.: 538/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 51-të, të mbajtur më 23 Qershor 2017, mori:

V E N D I M

I. Nuk akreditohet programi i studimit i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”:

- Shkenca e Ushqimit, MSc 120 ECTS

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim të programit të studimit: Shkenca e Ushqimit, MSc 120 ECTS , me stafin akademik si në vijim:

Nr.	Programi i studimit	Niveli	ECTS	Bartësit e Programit
1	Shkenca e Ushqimit	MSc	120	Hysen Bytyqi, Agim Rexhepi, dhe Driton Çausi

AKA ka organizuar vizitën në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë më 11.05.2017, me qëllim të vlerësimit të programit të studimit të cekur më sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Joachim Mueller dhe Reiner Doluschitz.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 23 qershor 2017 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë, dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve të akreditimit gjatë realizimit të vizitës, dhe në rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportin final nga ekspertët e cekur më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Raporti i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit, numëron këto vërejtje kryesore të cilat kanë qar në mos dhënien e rekomandimit për akreditim:

Bartësit e programit të studimit të cilët kanë mbrojtur programin e studimit nuk kanë qenë të përfshirë në zhvillimin dhe hartimin e programit MSc në Shkencat e Ushqimit dhe nuk janë paraparë të jenë pjesë e stafit ligjërues në të ardhmen për këtë program të studimit. Meqenëse njëri nga bartësit kryesor të programit të studimit nuk ishte prezent gjatë procesit të akreditimit, ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit nuk ka qenë në gjendje që të debatojë me pjesën tjetër të bartësve të programit në lidhje me çështjet e ngritura në Raportin e Vet Vlerësimit dhe rrjedhimisht shumë pyetje nuk kanë marrë përgjigje të duhura.

Në anën tjetër, sipas raportit të ekspertëve ndërkombëtarë, Fakulteti i Bujqësisë për arsye të krahasueshmërisë ndërkombëtare të programit të studimit kishte marrë si model Universitetin e Lubjanës dhe shumicën e lëndëve i kishte kopjuar një nga një, dhe në disa raste edhe pjesë të mëdha të përmbajtjeve të tyre. Sipas ekspertëve, struktura dhe përmbajtja e lëndëve duhet ti adoptohet kërkesave të Kosovës dhe gjithashtu potencialit mësimdhënës të fakultetit. Prandaj sipas tyre Fakulteti duhet të bëjë rishikim të detajuar të Raportit të Vet Vlerësimit. Ky rishikim sipas ekipit të ekspertëve duhet të bëhet edhe për sa i përket projekteve ndërkombëtare në fushën e hulumtimit dhe arsimit të lartë.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet kërkesë për rishqyrtim të vendimit sipas nenit 126, pika 2 a, të Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28. Kërkesa për rishqyrtim të vendimit i dorëzohet Agjencinë e Kosovës për Akreditim në afatin prej 30 ditëve nga data e pranimit të këtij vendimi siç është përcaktuar në nenin 130, pika 1 e Ligjit mbi Procedurën Administrative.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë